

Mv 429107
07.07.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150



MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË

VOLTANA ADEMI

Rregullore mbi hapësirat e prenotueshme për parkim automjesh

Baza Ligjore :

Në mbështetje Ligji Nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 107/2014” Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, V.K.M 408, datë 13.05.2015. “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, ligjinr.8378,datë22.07.1998” Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligji nr. 8743, date 22.02.2001 “ Për pronat e paluajtshme të shtetit “, Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, ”Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “ Për Sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar, V.K.M nr.1096, datë 28.12.2015 “ Për miratimin e rregullave kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësires publike, V.K.M nr.1, datë 22.01.2016 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i plotësuar

Hyrje

Shtimi i automjeteve në qytet, kërkesa përherë në rritje për parkim pranë qendrës së qytetit ka bërë që shumë subjekte juridik, fizik, publik ose privat, të kërkojnë një hapësirë të posaçme për parkimin e automjetit me të cilin zhvillojnë aktivitetin e tyre. Prenotimi i kësaj hapësire është bërë në kuadër të një shume të caktuar e cila ka sjellë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Shkodër

Kërkesat përherë e në rritje për parkim të prenotuar, ka sjellë nevojën për një plan të përgjithshëm të qytetit për ofrimin e këtyre hapësirave, i cili merr në konsideratë edhe aspekte të tjera të përdorimit të hapësirës rrugore si vendqëndrimet e autobusëve urbanë, taksive urban dhe ndërqytetas, vijat e bardha, korsitë e biçikletave, si dhe vendeve ku nuk mund të parkohet, ose nuk mund të bëhet prenotimi i parkimit. Plani parashikon edhe vendparkimet e posaçme vetëm për personat me aftësi të kufizuar lëvizjeje (PAKL) dhe invalidët.

Plani është përqëndruar në zonat ku ka kërkesa të vazhdueshme për prenotim parkimi, pranë institucioneve, pranë qendrës dhe bulevardeve kryesore. Nuk janë përfshirë në plan akse ku kërkesa për prenotim parkimi ka qënë inekzistente, ku nuk ka prezencë të lartë makinash dhe parkimi i automjeteve është i disponueshëm gjatë gjithë ditës.

Përkufizime

- **Hapësira për vendparkime të prenotueshme:** Me hapësirë për vendparkime të prenotueshme nënkuptojme hapësirën publike të vendosur jashtë karrexhatës në të cilën subjekti juridik, fizik, publik ose privat mund të prenotojë me tarifën përkatëse të përcaktuar nga Bashkia Shkodër, një ose më tepër vendparkime për automjet veturë. *Ky vendparkim i përket automjetit (targës) mbi të cilin është bërë marrëveshja. Vendparkimi nuk mund të zihet nga një automjet me targë tjetër i cili mund t'i përkasë subjektit prenotues, ose jo.*
- **Parkimi (vendparkimi):** zonë ose infrastrukturë e vendosur jashtë karrexhatës, e destinuar për qëndrimin e rregulluar ose jo të mjeteve.
- **Pjesë shërbimi:** quhen zonat e shërbimit me objektet përkatëse për furnizimin dhe pushimin e përdoruesve, zonat e parkimit, zonat dhe ndërtesat për mirëmbajtjen e rrugës apo gjithësesi të destinuara nga enti pronar ekskluzivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për t'i shërbyer rrugës dhe përdoruesve të saj. Pjesët e shërbimit të rrugës përcaktohen nga enti pronar i rrugës në bazë të akteve në zbatim të këtij neni dhe në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin a të kufizojnë fushëpamjen.

Në zonat e parkimit është e ndaluar:

- a) qëndrimi dhe ndalimi i mjeteve për të marrë pasagjerë;

- b) kryerja e veprimtarive tregtare ose propagandistike të çfarëdolloji; ato lejohen kur janë të autorizuar nga autoriteti vendor;
- c) kampimi, përveç zonave të destinuar për një gjë të tillë dhe për një periudhë të përcaktuar nga autoriteti vendor.
- d) kryerja e aktiviteteve tregtare ose shërbimi

Standartet e parkimit




Figura 1: Ilustrim Parkim kurriz-peshku

Është optimale që madhësia e parkimit të jetë nga 12 m² (6x2) deri në 13.75 m² (2.5 x 5.5). Nuk përjashtohen rastet kur sipërfaqja mund të jetë më e madhe, gjithmonë në varësi të rrethanave përkatëse. Por sidoqoftë ajo sillet zakonisht rreth 12 m² me formatet:

- a. "Shirit" (2 x 6) dhe (2.4 x 5.5), ku gjerësia përcaktohet nga distanca e vijës së trotuarit. Formatet më të ndjekur është ai me 2.4 x 5.5 i cili optimizon shfrytëzimin e hapësirës për parkim në bulevardet dhe rrugët e qytetit. Ndërsa formatet 2 x 6 është ndjekur në rrugët e ngushta me gjerësi 5-6m. Ky format (2x6m) është përdorur në rrugët "Kardinal Mikel Koliqi", "Hasan Riza Pasha", "Vaso Pasha" dhe pjesërisht në rrugën "Dr. Selaudin Bekteshi"
- b. "Krehër" (2.4 x 5) ose (2.5 x 4.8)
- c. Si dhe "Kurriz peshku" (2.4 x 4.8) dhe (2.5 x 4.5)

Për vendosjen në mënyrë diagonale "Kurriz peshku" ekzistojnë tre tipe këndesh 30 gradë, 45 gradë dhe 60 gradë.




Figura 2: Ilustrim parkim shirit

b. Mjetet në shërbim të personave me aftësi të kufizuar lëvizjeje (PAKL) duhet të parashikohen minimumi në çdo 50 vende parkim dhe gjerësia e tyre jo me e madhe se 3.2 m. Ndërkohë është lënë minimumi nga një parkim për PAKL për çdo institucion publik, institucion arsimor dhe fëtar. Gjithashtu dhe në prani të parqeve ose shërbimeve të tjera publike. Institucionet me frekuentim të lartë kanë dy ose tre nga këto vendparkime.

c. Vendparkimet e autorizuara në shërbim të PAKL nuk janë të detyruar të respektojnë kufijtë e kohës kur pushojnë në zonat e parkimit me kohë të kufizuar.




Figura 3: Ilustrim parkimi (krehër) për persona me aftësi të kufizuar lëvizjeje dhe sinjalistika përkatëse

Sinjalistika e parkimit




Figura 4: Ilustrim i sinjalistikes së vendparkimit të prenotuar

- Sinjalistika vertikale e parkimit duhet të ketë një tabelë vertikale me logon “P” të bardhë në një katror blu, si më lart, me emrin e subjektit, ditët dhe orarin përkatës. Tabela duhet të ketë përmasat 50 x 80 minimumi dhe të jetë e vendosur jo më poshtë se 200cm nga niveli i trotuarit.
- Sinjalistika horizontale duhet të jetë i vijëzuar me të verdhë ku vija duhet të jetë me trashësi 10cm. me simbolin “P” sipas ilustrimit të mësipërm.

Kriteret e përcaktimit të parkimeve për automjetet:

- Vendparkimi i prenotuar fillon minimumi 1m larg nga vijat e bardha.

- 
- Nuk duhet të pengojë autobuzin urban për të kryer manovrën e ndalimit dhe nuk duhet të prekë zonën e manovrimit e cila është minimumi 6 m e gjatë dhe shënohet me vijëzim zig-zag. Një ndalesë autobuzi duhet të jetë minimumi 14m e gjatë, plus 6m zonë manovre para dhe prapa, pra 26m në total.
 - Nuk duhet të ndodhet në zonat e miratuara me VKB për taksitë, linjat urbane, interurbane dhe ndërkombëtare.
 - Nuk mund të jetë në një korsi biçiklete.
 - Nuk mund të jetë i mbivendosur mbi një parkim të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar lëvizjeje.
 - Nuk mund të jetë i mbivendosur në vendet e miratuara për autobusët shkollore, ambulancat, por edhe në vendparkimet e rezervuara për subjektet e tjera.

Afatet : Lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike për parking të prenotueshëm jepen për një periudhë jo më të vogël se një 1 vit (365 dite kalendarike), jo më pak se 8 orë në ditë, si dhe jo më pak se 5 ditë në javë.

Pas përfundimit të afatit të lejes së dhënë, leja quhet e miratuar automatikisht në momentin e nënshkrimit të kontratës së re aktuale ndërmjet palëve.

Për subjektet të cilëve i ka mbaruar kontrata në vitin 2016, detyrimi kontraktual i ri do të fillojë që nga data e mbarimit të kontratës, ndërsa atyre që u ka mbaruar kontrata vitet e mëparshme, detyrimi kontraktual i ri do të fillojë në datën e miratimit të lejes së re.